



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Transaksioni i përftimit të kontrollit, nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është njoftuar transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Saudi Aramco Development Company (SADCO) dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker Hughes).

Palët në transaksion janë:

Saudi Aramco Development Company (SADCO) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Arabinë Saudite. SADCO zotërohet plotësisht nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company “Saudi Aramco”, e cila merret kryesisht me prodhimin dhe tregtimin e naftës, gazit, shërbimeve dhe fushave prodhuese.

Baker Hughes Company është një shoqëri aksionere e themeluar në vitin 2016, e ndryshuar më datë 03.07.2017 pasi u bashkua me Ge Oil & Gas për tu bërë Baker Hughes Company.

Baker Hughes Company është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive **Baker Hughes**, e cila është ofruese shërbimesh dhe produktesh të integruara të fushave naftëmbajtëse.

Grupi Baker Hughes ka një degë të regjistruar në Shqipëri, përkatësisht Western Atlas International LLC, e cila ka objekt aktiviteti: produktet, ku përfshihen pajisjet për përfundim punimesh dhe pajisjet artificiale në fushat naftëmbajtëse dhe Shërbimet, ku përfshihen shërbimi gërryes, goditës dhe shpues në fushat naftëmbajtëse¹.

Shoqëria e re (Joint Venture) do të jetë një shoqëri e përbashkët e cila do të krijohet sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe do të operojë në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.

Palët kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje e Joint Venture”, ndërmjet shoqërive Saudi Aramco Development Company (SADCO) nga njëra anë dhe Ge Oil & Gas Uk Limited (Baker

¹ Burimi: Ekstrakti Historik i shoqërisë Western Atlas International LLC

Hughes) nga ana tjetër dhe kanë rënë dakord që të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) të krijuar rishtas.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Diana Dervishi